

Meqë gripi transmetohet nga nga një njeri tek tjetri, ka mundësi që nëna ose personat e tjerë që kujdesen për foshnjën të preken nga gripi dhe pastaj ta përcjellin infeksionin edhe tek foshnja. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të gjithë ata që jetojnë dhe kujdesen për foshnjën, si dhe anëtarët e tjerë të familjes, të vaksinohen kundër gripit.

TË BËJMË QË TË JETË MË MIRË!

NËNA TË ARDHSHME, VAKSINOHUNI NË KOHË SEPSE GRIPI ËSHTË NJË SËMUNDJE E RËNDË QË MUND TË JETË KËRCËNUESE PËR SHËNDETIN TUAJ DHE TË FËMIJËVE TUAJ!



E RËNDËSISHME!

VAKSINIMI PËR GRATË SHTATZËNA ËSHTË FALAS!

CAKTONI TERMIN PËR VAKSINIM NËPËRMJET PLATFORMËS ONLINE!

Caktimi i termineve për vaksinim me vakcina falas bëhet nëpërmjet ueb-faqes www.vaksinacija.mk

Me plotësimin e formularit ju regjistroheni për vaksinim drejtpërdrejt në sistemin Termini Im. Me anë të një mesazhi SMS ju do të informoheni për datën dhe orën e saktë të vaksinimit në pikën e vaksinimit që e keni zgjidhur gjatë regjistrimit.

Përveç këtyre vaksinave, ju mund të vaksinoheni me vakcina komerciale kundër gripit sezonal në Qendrën më të afërt të Shëndetit Publik pa caktuar paraprakisht një termin.

Jeni shtatzënë?

KENI NEVOJË PËR VAKSINË KUNDËR GRIPI!

ÇDO GRUA SHTATZËNË DUHET TË VAKSINOHET QË TA MBROJË VETEN DHE FËMIJËN E SAJ!

GRIPI MUND TË JETË NJË SËMUNDJE E RËNDË DHE TË SHKAKTOJË PROBLEME SERIOZE SHËNDETËSORE, VEÇANËRISHT NËSE JENI SHTATZËNË.



Edhe në rast se një grua shtatzënë është e shëndetshme, ndryshimet në sistemin imunologjik, funksionin e zemrës dhe të mushkërive që mund t'i shkaktojë virusi i gripit gjatë shtatzënisë rrisin gjasat që sëmundja të përparojë në një formë të rëndë të gripit.

Vaksina kundër gripit rekomandohet në cilën do fazë të shtatzënisë sepse:

- e zvogëlon rrezikun që Ju të prekeni nga gripi
- e mbron fëmijën Tuaj nga gripi edhe disa muaj pas lindjes!

Gratë shtatzëna (edhe lehonat, deri më dy javë pas lindjes) që infektohen nga gripi janë të ekspozuara ndaj një rreziku më të madh nga zhvillimi i një forme të rëndë të sëmundjes, që mund të ketë si rezultat edhe shtrimin në spital. Një studim nga viti 2018 ka zbuluar se vaksinimi kundër gripit e zvogëlon rrezikun nga hospitalizimi tek gratë shtatzëna me grip mesatarisht për 40%.

Gripi mund të shkaktojë pasoja të dëmshme në zhvillimin e foshnjës së palindur të gruas shtatzënë dhe sëmundje të rëndë tek foshnja pas lindjes.

VAKSINA KUNDËR GRIPIT ËSHTË MBROJTJA MË E MIRË E DISPONUESHME PËR GRUAN SHTATZËNË DHE FOSHNJËN E SAJ!

Pas marrjes së vaksinës kundër gripit organizmi i gruas shtatzënë fillon të krijojë antitropa, të cilët ndihmojnë në parandalimin e gripit.

Antitrupat përcillen tek fetusin që po zhvillohet dhe ndihmojnë që të mbrohet nga gripi edhe për disa muaj pas lindjes. Kjo është e rëndësishme sepse foshnjat nën 6 muaj janë tepër të vegjël për ta marrë vaksinën kundër gripit (vaksina u jepet vetëm fëmijëve mbi 6 muaj).

Antitrupat mund të përcillen tek të porsalindurit edhe nëpërmjet qumështit, nëse nëna e ushqen fëmijën me gji - pavarësisht nëse e ka marrë vaksinën gjatë shtatzënisë apo pas lindjes.



VAKSINAT KUNDËR GRIPIT JANË TË SIGURTA PËR GRATË SHTATZËNA DHE NËNAT QË USHQEJNË FOSHNJËN ME GJI.

Nëse fëmija juaj lind para se Ju të jeni vaksinuar kundër gripit, përsëri nuk është vonë dhe duhet të vaksinoheni edhe pas lindjes!

Miliona gra shtatzëna në mbarë botën vaksinohen kundër gripit çdo vit! Vaksinat kanë një rekord të shkëlqyer nga aspekti i sigurisë, gjë që e kanë dëshmuar studime të shumta.

VAKSINA KUNDËR GRIPIT NUK MUND TË SHKAKTOJË GRIP.

EFEKTET E PADËSHIRUARA TË ZAKONSHMË TË VAKSINËS KUNDËR GRIPIT JANË TË LEHTA.

Pas marrjes së vaksinës kundër gripit mund të përjetoni disa efekte të padëshiruara që zakonisht janë të lehta. Efekt më i shpeshtë i padëshiruar është reaksioni lokal në vendin e injektimit të vaksinës si dhimbje, ndjeshmëri, skuqje dhe/ose ënjtje.

Më rrallë, disa gra shtatzëna mund të përjetojnë dhimbje të kokës, dhimbje të muskujve, ethe dhe nauze ose ndjenjë të lodhjes.